<p>Departamenti i Mjedisit dhe miratohet nga Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë.</p> <p>5. Me qëllim që të përmbushen objektivat për zvogëlimin e mbeturinave biodegraduese sipas nënparagrafit 2.8 të nenit 7 të Ligjit për mbeturina, operatori i deponisë duhet që për çdo vit kalendarik të trajtoj mbeturinat biodegraduese në masë të caktuar nga autoriteti kompetent.</p> <p>6. Mbeturinat biodegraduese të trajtuara, përveq shfrytëzimit si kompost ato mund të përdoren edhe si shtresë për mbulimin e mbeturinave në deponi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Mbeturinat që nuk lejohen të pranohen në deponi të mbeturinave</b></p> <p>1. Në deponi të mbeturinave sipas nenit 5, paragrafi 1 të këtij Udhëzimi Administrativ, operatorët e deponive janë të detyruar që mos t'i pranojnë mbeturinat për deponim si në vijim:</p> <p style="text-align: center;">1.1. mbeturinat e lëngëta;</p>	<p>Department of Environment and approved by the Secretary General of the Ministry.</p> <p>5. In order to meet targets for reducing biodegradable waste under sub-paragraph 2.8, of article 7 of the Law on waste, the landfill operator shall for each calendar year to treat biodegradable waste in certain mass by the competent authority.</p> <p>6. Biodegradable waste treated, except for use as compost, can be used as a layer for the coverage of waste in landfills.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Wastes that are not accepted in the landfill</b></p> <p>1. In the landfills, according to the article 5, paragraph 1, of this Administrative Instruction, landfill operators are obligated to not accept wastes as following:</p> <p style="text-align: center;">1.1. liquid wastes;</p>	<p>odobreni od strane Generalnog sekretara Ministarstva.</p> <p>5. U cilju ispunjavanja objekta za smanjenje biorazgradivog otpada na osnovu člana 7, podstav 2.8 Zakona o otpadu, operater deponije treba da za svaku kalendarisku godinu tretira biorazgradivi otpad u meri utvrđene od nadležnog organa.</p> <p>6. Tretirani biorazgradivi otpad osim korišćenja kao kompost može se koristiti kao sloj za pokrivanje otpada u deponiji.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Otpad koji nije dozvoljen za odlaganje u deponiji</b></p> <p>1. U deponijama otpada na osnovu člana 5, stava 1, ovog Administrativnog Uputstva, operateri deponija dužni su da ne prihvataju otpad za skladištenje kao u sledećem:</p> <p style="text-align: center;">1.1. tečan otpad;</p>
---	--	--

<p>1.2. mbeturinat të cilat në kushte të deponive janë eksplozive, korrozive, oksiduese, shumë të ndezshme apo të ndezshme, siç definoohen në Shtojcën 03 - Lista H1, H8, H2, H3-A, H3-B të Ligjit për Mbeturina;</p> <p>1.3. të gjitha gomat e përdorura me përjashtim kur përdoret si material për rregullimin dhe mbrotjen e deponisë dhe gomat me diametër prej 1 400 mm, ose gomat e biçikletave;</p> <p>1.4. mbeturinat medicinale, veterinare dhe të tjera të cilat janë infektuese, toksike, kancerogjene, mutagjene siç definoohen në shtojcën 03 - Lista H9, H6, H7, H11, të Ligjit për Mbeturina;</p> <p>1.5. nën-produktet shtazore, kërmat e shtazëve që nuk janë therrë por kanë ngordhur, përfshirë shtazët e mbytura për t'i zhdukur sëmundjet epizootike;</p> <p>1.6. mbeturinat laboratorike, substancat kimike nga hulumtimi dhe zhvillimi i aktiviteteve apo veprimtarive arsimore si dhe substancat të cilat reagojnë në kontakt me ujë;</p>	<p>1.2. wastes, which in real condition are explosive substances, corrosive, oxidants, inflammable or very inflammable, as it is defined on annex 03 - list H1, H8, H2, H3-A, H3-B of Waste Law;</p> <p>1.3. all used tires unless the material used as content for the regulation and protection of landfill and tires with a diameter of 1 400 mm, or bicycle tires;</p> <p>1.4. medical and veterinarian wastes which are infectious, toxic, cancerous, mutagen as defined on annex 03 - list H9, H6, H7, H11, of the Waste Law;</p> <p>1.5. animal sub-products, animal carcass that are not slaughter but they are dead, including animals strangled missing to epizootic;</p> <p>1.6. laboratory waste, chemical substances from the research and development activities or educational activities and substances that react in contact with water;</p>	<p>1.2. otpad koji je pod uslovima skladistenja eksplozivan, korozivan, oksidirajući, mnogo osetljiv ili zapaljiv, kao što je dato u dodatku 03 - Listi H1, H8, H2, H3-A, H3-B Zakona o Otpadu;</p> <p>1.3. sve upotrebljene gume sa izuzetkom kada se koristi kao materijal za regulisanje i zaštitu deponije i gume prečnika od 1400 mm, ili bicikletske gume;</p> <p>1.4. medicinski i veterinarski otpad koji je infekcioni, toksični, kancerogeni, mutageni kao što je dato u dodatku 03 - Listi H9, H6, H7, H11, Zakona o Otpadu;</p> <p>1.5. životinjski nusproizvodi, životinjski leševi koji nisu zaklani nego su uginuli, uključujući ubijene životinje radi otklanjanja serijskih bolesti;</p> <p>1.6. laboratorijski otpad, hemijske supstance iz istraživanja i razvoj aktivnosti ili obrazovne delatnosti i supstance koji reaguju u kontaktu sa vodom;</p>
---	---	---



<p>1.7. të gjitha mbeturinat e riciklueshme, përveç mbeturinave komunale;</p> <p>1.8. çdo lloj tjetër mbeturine që nuk i plotësonë kushtet e përcaktuara me leje/licencë;</p> <p>1.9. mbeturinat e automjeteve, bateritë dhe akumulatorët, me përjashtim të mbeturinave nga përpunimi i baterive dhe akumulatorëve pas riciklimit;</p> <p>1.10. mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, me përjashtim të mbeturinave nga përpunimi i mbeturinave të pajisjeve elektrike dhe elektronike pas riciklimit;</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Mënyra e deponimit të mbeturinave në deponi</b></p> <p>Aktivitetet me rastin e hedhjes apo deponimit të mbeturinave në deponi, përshkruhen sipas listës D në Shtojcën 01 të Ligjit për Mbeturina.</p>	<p>1.7. all recyclable waste, in addition to municipal waste;</p> <p>1.8. any other type of waste that do not fulfills the conditions determined by the permit/license;</p> <p>1.9. waste vehicles, batteries and accumulators, with the exception of waste from processing after recycling batteries and accumulators;</p> <p>1.10. waste from electrical and electronic equipment, with the exception of waste from processing waste electrical and electronic equipment after the recycling.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Manner of waste storage on the landfill</b></p> <p>Activities in case of discharge or testimony of wastes on the landfill are described according to the list D on Annex 01 of the Waste Law.</p>	<p>1.7. sav reciklirani otpad osim komunalnog otpada;</p> <p>1.8. svaka druga vrsta otpada koja ne ispunjava uslove utvrđene licencom;</p> <p>1.9. otpad od vozila, baterija i akumulatora, sa izuzetkom otpada od tretmana baterija i akumulatora nakon recikliranja;</p> <p>1.10. otpad od električne i elektronike opreme, sa izuzetkom otpada od tretmana otpada električne i elektronske opreme nakon recikliranja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Nacin skladistenja otpada u deponiji</b></p> <p>Delatnosti u slucaju bacanja ili skladistenja otpada u deponiji, opisan je prema listi D u dodatku 01 Zakona o Otpadu.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Objektetet dhe pajisjet për trajtimin e mbeturinave në deponi</b></p> <p>1. Çdo deponi duhet ti ketë objektet e nevojshme të domosdoshme si: zyren e personelit, objektin higjieniko-sanitar, peshoren për matjen e mbeturinave dhe sipas nevojës kontejner të mjaftueshëm për ndarje të mbeturinave.</p> <p>2. Parkingu dhe hapësira për hyrje dalje të ngarkesave me mbeturina duhet të përputhet me kapacitetin ditor të pranimit të mbeturinave në deponi.</p> <p>3. Përveç objekteve sipas paragrafit 1 të këtij neni, në deponi mund të ndërtohen edhe objekte tjera për trajtimin, riciklimin, magazinim dhe djegien e mbeturinave me qëllim të përfitimit të energjisë nga mbeturinat.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Equipment of waste treatment on landfill</b></p> <p>1. Each landfill must have the necessary facilities needed as office personnel, hygiene and facility sanitation, waste measurement scale content for, and sufficient container needed for waste separation.</p> <p>2. Parking spaces for incoming and outgoing cargo waste must comply with the daily capacity of the landfill waste acceptance.</p> <p>3. Apart from facilities under paragraph 1 of this article, nw landfill may be constructed other facilities for treatment, recycling, storage and incineration of waste with tw qwillim benefit from waste energy.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Objekti i oprema za tretman otpada u deponiji</b></p> <p>1. Svaka deponija mora imati neophodne objekte kao: kancelariju za poslovno osoblje, higijensko-sanitarni objekt, vagu za merenje otpada, i prema potrebi kontejner dovoljan za odvajanje otpada.</p> <p>2. Parking i prostor za ulaz i izlaz tereta od otpada treba biti u skladu sa dnevnim kapacitetom prihvatanja otpada u deponiji.</p> <p>3. Osim objekata na osnovu stava 1 ovog člana, u deponiji se može izgraditi i drugi objekti za tretman, reciklažu, skladištenje i sagorevanje otpada u cilju dobijanja energije iz otpada.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Detyrimet e operatorit të deponisë</b></p> <p>1. Operatori i deponisë, duhet të caktojë personin përgjegjës me pergaditje universitare dhe me pervojë pune në fushën e menaxhimit të mbeturinave.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Obligations of the landfill operator</b></p> <p>1. The landfill operator shall designate a responsible person with university preparation and experience in the field of waste management;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Obaveze operatera deponije</b></p> <p>1. Operater deponije, mora da imenuje kvalifikovano odgovorno lice sa universitetskom diplomom radnim iskustvom u oblasti upravljanja otpada.</p>

<p>2. Personi përgjegjës nga paragrafi 1, i këtij neni, ka për obligim të koordinoj punët në deponi, sipas nenit 8, 14, 15, 16, 17, 18, 25, 26 dhe 27 si dhe të mbikqyrë dhe monitoroj procesin e deponimit të mbeturinave sipas nenit 7, të këtij Udhëzimi Administrativ. Nëse përgjegjësit e punëve të përmendura më lartë nga operatori i deponisë janë deleguar tek personat tjerë, duhet caktuar me shkrim.</p> <p>3. Operatori i deponisë përveç detyrimeve nga paragrafi 1 dhe 2, të këtij neni duhet, të:</p> <p>3.1. menaxhoj deponinë sipas planit për menaxhimin e deponisë;</p> <p>3.2. organizojë ndarjen e mbeturinave që mund të shfrytëzohen, ripërdoren dhe riciklohen;</p> <p>3.3. zbatojë masat për të reduktuar dhe parandaluar ndikimet negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut nga:</p> <p>3.3.1. emisioni i gazrave, kundërmimit dhe pluhurit;</p>	<p>2. Responsible person from paragraph 1, of this article, has obligation to coordinate works of articles 8, 14, 15, 16, 17, 18, 25, 26 and 27 at the landfill as well as supervise and monitor the process of the waste storage according to the article 7, of this Administrative Instruction. If those responsible for the works mentioned above from the landfill operator are delegated to other persons must be appointed in writing.</p> <p>3. Landfill operator except obligations from paragraph 1 and 2 of this article must carry out also for:</p> <p>3.1. manage landfill according to the plan for landfill administration;</p> <p>3.2. organize waste separation which can be used, reused and recycled;</p> <p>3.3. implement measures to reduce and prevent negative impacts on environment and human health by:</p> <p>3.3.1. emission of fumes, smell and dust;</p>	<p>2. Odgovorno lice iz stava 1, ovog člana, ima za dužnost da uskladi radove članaka 8, 14, 15, 16, 17, 18, 25, 26 i 27 na deponiji kao i nadzor i praćenje procesa skladištenja otpada od Član 7 ovog Administrativnog Uputstva. Ako oni koji su odgovorni za dela gore pomenute operater deponije su delegirani i drugim licima mora biti postavljen u pisanoj formi.</p> <p>3. Operater deponije osim zadataka iz stava 1 i 2, ovog člana treba da:</p> <p>3.1. upravlja deponijom prema planu za upravljanje deponijom;</p> <p>3.2. organizuje odvajanje otpada koji moze da se ponovo koristi i reciklira;</p> <p>3.3. sprovodi mere za smanjenje i sprečavanje negativnih uticaja na sredinu i ljudsko zdravlje od:</p> <p>3.3.1. emisije gasova, mirisa i prašine;</p>
--	---	--

<p>3.3.2. zhurma dhe bartja e fraksioneve të lehta të mbeturinave nga erërat;</p> <p>3.3.3. zogjt, brejtësit dhe insektet;</p> <p>3.3.4. ndezja e mbeturinave.</p> <p>3.4. implementojë planin për menaxhimin e deponisë sipas nenit 7, të këtij Udhëzimit Administrativ.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Kontrolli i ujërave dhe menaxhimi i kullimit</b></p> <p>1. Në përputhje me karakteristikat e deponisë dhe kushtet meteorologjike të zonës merren masat e duhura, me qëllim të:</p> <p>1.1. kontrollimit të ujërave që futen në trupin e deponisë nga reshjet atmosferike;</p> <p>1.2. parandalimit të hyrjes së ujërave sipërfaqësore dhe/ose ujërave nëntokësore në mbeturinat e deponuara në deponi;</p>	<p>3.3.2. transmission of noise and light fractions of waste from the winds;</p> <p>3.3.3. birds, rodents and insects;</p> <p>3.3.4. igniting waste</p> <p>3.4. implement plan for landfill administration according to the article 7, of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Waters control and drainage management</b></p> <p>1. In accordance with the characteristics of the landfill and the meteorological conditions of the area, will undertake the necessary measures in order to:</p> <p>1.1. control of waters entering in the storage body from atmospheric precipitation;</p> <p>1.2. prevent the entry of surface waters and / or groundwaters at wastes deposited in the storage;</p>	<p>3.3.2. buke i nošenje lakih frakcija otpada od vetrova</p> <p>3.3.3. ptica, glodara i insekata;</p> <p>3.3.4. paljenje otpada.</p> <p>3.4. primeni plan za upravljanje deponijom na osnovu člana 7, ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Kontrola voda i upravljanje odvodnjavanja</b></p> <p>1. U skladu sa karakteristikama deponije i meteoroloških uslova na području preduzimaju se neophodne mere u cilju:</p> <p>1.1. kontrole voda koji prodiru u telo deponije od atmosferskih padavina;</p> <p>1.2. sprečavanja prodora površinske vode i / ili podzemnih voda u otpad deponovan na deponiji;</p>
---	---	--

<p>1.3. grumbullimit të ujërave të kontaminuara dhe lëngjet që kullojnë nga deponia;</p> <p>1.4. identifikimi/zbulimi dhe parandalimi i ndotjes së ujërave nëntokësore.</p> <p>2. Ujërat e grumbullura, të kontaminuara dhe të kulluara nga deponia, duhet të trajtohen për tu arritur kriteret të paraqitur në shtojcën 1. për të tri llojet e deponive që kërkohet për kullimin e deponisë para shkarkimit të tyre.</p> <p>3. Autoriteti kompetent mund të vendosë që dispozita e paragrafit 1 të këtij neni të mos zbatohet në qoftë se vlerësimi paraprak për vend ndodhjen e deponisë dhe mbeturinave që do të pranohen aty, konstaton se deponia nuk paraqet rrezik potencial për mjedisin.</p> <p>4. Dispozitat nga paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohen në deponit e mbeturinave inerte, nëse mbeturinat inerte të ndërtim/demolimit nuk janë të kontaminuara me mbeturina tjera.</p>	<p>1.3. collection of contaminated waste waters and fluids draining from the storage;</p> <p>1.4. detect and prevent pollution of groundwater.</p> <p>2. Collected waters, contaminated and drained from the landfill, must be addressed to achieve the criteria set out in Annex 1 to the three types of landfill required to drain the landfill before downloading them.</p> <p>3. The competent authority may decide that the provisions of paragraph 1 of this Article shall not apply if the preliminary assessment of the landfill location and the wastes to be accepted there, ascertain that landfill does not represent a potential risk to the environment.</p> <p>4. The provisions of paragraph 2 of this Article shall not apply to inert waste storages, whether inert construction waste / demolition is not contaminated with other wastes.</p>	<p>1.3. prikupljanje kontaminirane vode i tečnosti koji ističu iz deponije;</p> <p>1.4. otkrivanju i sprečavanju zagađenja podzemnih voda.</p> <p>2. Prikupljena, kontaminirana i iscedena voda, mora se tretirati da bi se postigli kriterijumi navedeni u Aneksu 1 za tri vrste deponije potrebnih za ceđenje deponije pre njihovog ispuštanja.</p> <p>3. Nadležni organ može odlučiti da se odredba stava 1. ovog člana ne primeni ako je prethodna procena o lokaciji deponije i otpada koji će se tamo prihvatiti, kostantuje da deponija ne predstavlja potencijalnu opasnost po životnu sredinu.</p> <p>4. Odredbe iz stava 2. ovog člana ne primjenjuju se na deponije za inertan otpad, ako inertni građevinski otpad / rušenja nije zagađen sa ostalim otpadom.</p>
--	--	---

<p align="center"><b>Neni 16</b> <b>Detyrimet e operatorit të deponisë së mbeturinave komunale</b></p>	<p align="center"><b>Article 16</b> <b>Obligations of the operator of municipal wastes landfill</b></p>	<p align="center"><b>Član 16</b> <b>Obaveze operatera deponije za komunalni otpad</b></p>
<p>1. Gjatë menaxhimit të deponisë, operatori duhet, të:</p> <p>1.1. zbatojë planin për monitorimin e deponisë dhe të ndër marrë masat e përcaktuara me leje;</p> <p>1.2. informojë autoritetin kompetent për ndikimet negative në mjedis që mund të identifikohen gjatë monitorimit të deponisë;</p> <p>1.3. sigurojë deponinë me rrethojë fizike në lartësi minimale prej 2 metrave dhe elemente tjera sigurie;</p> <p>1.4. bëjë kontrollime të rregullta të trupit të deponis dhe të funksionimit teknik të objekteve dhe paisjeve të deponisë;</p> <p>1.5. jasht rrethojës së deponis të bëjë pastrimin dhe largimin e mbeturinave të bartura nga era;</p>	<p>1. During landfill management, operator should take care as following:</p> <p>1.1. implement program for landfill monitoring and to undertake determinate measures by permit;</p> <p>1.2. inform competent authority for environment negative impact which can identify during the landfill monitoring;</p> <p>1.3. provide physical fence landfill minimum height of 2 meters and other security elements;</p> <p>1.4. conduct regular inspections of the dump body and teknit operation of facilities and equipment to landfill;</p> <p>1.5. landfill outside cleaning and removal of waste carried by wind;</p>	<p>1. U toku upravljanja deponijom, operater treba da:</p> <p>1.1. sprovede plan i program za monitorin deponije i da preduzme mere odredene dozvola;</p> <p>1.2. informiše nadležni organ za negativne uticaje na životnu sredinu koji moze da se identifikuje tokom monitoringa deponije;</p> <p>1.3. osigura deponiju sa fizičkom ogradom minimalne visine od 2 metra i druge bezbedonosne mere;</p> <p>1.4. vrši redovnu kontrolu tela deponije i tehničkog funkcionisanja objekata i opreme deponije;</p> <p>1.5. van ograde deponije vrši čišćenje i otklanjanje otpada nošene vetrom;</p>

<p>1.6. kontrollojë dhe mirëmbajë sistemin e drenazhimit për kullimin e ujërave nga deponia;</p> <p>1.7. bëjë mirëmbajtjen e vazhdueshme për funksionimin e sistemit të pompave për riqarkullimin e kullimit në deponi;</p> <p>1.8. instaloj paisjet dhe të bëjë mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit për mbledhjen e gazrave të deponisë për shfrytëzimin e tyre;</p> <p>1.9. ndërmarrë masa për shuarjen e zjarrit në deponi;</p> <p>1.10. mirëmbaj infrastrukturën rrugore brenda deponisë;</p> <p>1.11. vendosë shenja dhe tabela informuese, skicën e deponisë, kohën e pranimit të mbeturinave, llojin e mbeturinave, rreziqet eventuale dhe informata të tjera relevante;</p> <p>1.12. kompaktojë dhe mbulojë vazhdimisht mbeturinat komunale me shtresë dheu;</p> <p>1.13. bëjë dezinfektimin e deponisë kur</p>	<p>1.6. inspect and maintain drainage system to drain water from the landfill;</p> <p>1.7. ongoing maintenance to make the functioning of the new circulation pumps for drainage in landfills;</p> <p>1.8. install equipment and make ongoing maintenance of the system to collect landfill gas content for their use to;</p> <p>1.9. undertake measures to extinguish the fire in the landfill;</p> <p>1.10. maintain road infrastructure within the landfill;</p> <p>1.11. decide signs and information tables, the design of landfill waste the time of admission, type of waste, possible risks and other relevant information;</p> <p>1.12. to compact and cover continually the municipal wastes with soil coverage;</p> <p>1.13. carry out disinfection of landfill</p>	<p>1.6. kontroliše i održava drenažni sistem za filtraciju voda iz deponije;</p> <p>1.7. vrši stalno održavanje sistema za funkcionisanje sistema pumpi za recirkulaciju iscedjevina u deponiji;</p> <p>1.8. instalira opremu i vrši stalno održavanje sistema za sakupljanje gasova deponije za njihovo korišćenje;</p> <p>1.9. preduzima mere za gašenje eventualnog požara u deponiji;</p> <p>1.10. održava putnu infrastrukturu unutar deponije;</p> <p>1.11. stavlja znakove i informativne tabele, skicu deponije, vreme odlaganja na deponiju, vrstu otpada, eventualne opasnosti i druge značajne informacije;</p> <p>1.12. kompaktira i neprestano zatvara komunalni otpad slojem zemljišta;</p> <p>1.13. vrši dezinfekciju deponije prema</p>
--	--	---

<p>paraqitet nevoja;</p> <p>1.14. Ndalojë hyrjen e personave të pa autorizuar.</p> <p>1.15. zbatojë urdhëresat e inspektoratit mjedisor për evitimin dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis dhe të zbatojë masat për përmismin e gjendjes, brenda afatit të caktuar nga inspektorati mjedisor;</p> <p>1.16. në rastet kur masat e përshkruara në nën paragrafin 1.15. të këtij neni nuk ndërmerren nga operatori i deponisë, caktohet një palë e tretë me shpenzimet e operatorit.</p> <p>2. Gjatë trajtimit të kullimit të deponisë me procese fizike-kimike, operatori i deponisë me rastin e shkarkimit të kullimit jashtë deponisë, është i obliguar t'u përmbahet vlerave referente për kullimin të përshkruar në shtojcën 1, të këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>where it necessary;</p> <p>1.14. prohibit enter of unauthorized persons.</p> <p>1.15. implement competent authorities for eviction of negative impacts in the environment and implement the measures for improvement of conditions within limited period defined by environmental inspectorate;</p> <p>1.16. in cases when the measures described in subparagraph 1.15. of this article are not taken by the operator of storage, will be assigned a third party under operator costs.</p> <p>2. During the drainage treatment of landfill with physic- chemical process, operator of landfill in case of filtration discharge, he must refer the adequate values for filtration described on the annex 1, of this Administrative Instruction.</p>	<p>potrebi;</p> <p>1.14. zabranjuje ulaz neovlašćenim licima.</p> <p>1.15. sprovodi naredbe inspektorata sredine za izbegavanje i sprečavanje negativnih uticaja na sredinu i da sprovodi mere za poboljšanja stanja, u utvrđenom roku od inspektorata sredine;</p> <p>1.16. u slučajevima kada opisane mere u osnovu 1.15. ovog člana se ne preduzmu od operatera deponije, imenuje se treća stranka o trošku operatera.</p> <p>2. U toku tretmana procednih voda iz deponije fiziko-hemijskim procesima, operater deponije u slučaju ceđenja van deponije, obavezan je da se pridržava referentnim vrednostima za procedne vode opisane u dodatku 1, ovog Administrativnog Uputstva.</p>
--	---	--



<p style="text-align: center;"><b>Neni 17 Raportimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17 Reporting</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17 Izveštavanje</b></p>
<p>1. Operatori i deponisë, gjatë fazës operuese të deponisë, është i obliguar të raportoj në Ministri për vitin e kaluar, sipas paragrafit 3 dhe 4 të nenit 58 të ligjit për mbeturina, deri me 31 mars të vitit vijues.</p> <p>2. Raporti vjetor duhet të përmbajë:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. të dhëna për operatorin që menaxhon deponin, sipas shtojcës 3 të këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. të dhëna për kullimin dhe emisionet e gazrave të deponisë, Shtojca 2, tabela II, e këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. të dhëna për monitorim e ujërave nëntokësore në deponi, Shtojca 2, tabela III, e këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.4. të dhëna tjera të kërkuara për deponinë.</p> <p>3. Pas mbylljes përfundimtare të deponisë,</p>	<p>1. Operator of the landfill, during the stage of operation, is obliged to report to the Ministry for the last year, according to paragraph 3 and 4 of Article 58 of the law on waste, until March 31 of the following year.</p> <p>2. The annual report must contain:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. data of operation that manages the landfill, according to Annex 3 of this Administrative Instruction ;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. data for drainage and landfill gas emissions, Annex 2, Table II of this Administrative Instruction;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. data for monitoring of groundwater in landfills, Annex 2, Table III, of this Administrative Instruction;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.4. other relevant data required for the landfill.</p> <p>3. After the final closure of the landfill, the</p>	<p>1. Operater deponije, u toku operativne faze, dužan je da izveštava Ministarstu o protekloj godini, prema stavu 3 i 4 član 58, Zakona o otpadu, do 31 marta naredne godine.</p> <p>2. Godišnji izvešaj mora sadržati:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. podatke o operateru koji upravlja deponijom; prema Dodataku 3, ovog Administrativnog Uputstva;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. podatke o drenažiranju i emisiji gasova deponije, Dodatak 2, tabela II ovog Administrativnog Uputstva;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. podatke o praćenju podzemnih voda u deponiji , Dodatak 2, tabela III ovog Administrativnog uputstva;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.4. druge relevantne podatke o deponiji.</p> <p>3. Posle završnog zatvaranja deponije,</p>

<p>operatori është i detyruar të raportojë për gjendjen e deponis çdo vit, në pesë (5) vitet e para, ndërsa pas kësaj periudhe në çdo tre (3) vjet.</p> <p>4. Përjashtimisht nga paragrafi 3, në raste të çfarëdo aktiviteti dhe ndryshimi që mund të ndodhë në deponi, operatori menjëherë është i detyruar ta informojë autoritetin kompetent.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Mbrojtja dhe siguria në punë</b></p> <p>Operatori i deponisë është i obliguar t'i përmbahet Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Zhvendosja e mbeturinave nga deponit</b></p> <p>Zhvendosja e mbeturinave të deponisë, mund të bëhet vetëm nëse mbeturinat dërgohen për shrytëzim në impiantin për djegëje të mbeturinave për përfitim të energjisë ose në impiantin për riciklim të mbeturinave.</p>	<p>operator is obliged to report on the status of the landfill each year in five (5) years before, and after this period in every three (3) years.</p> <p>4. Notwithstanding of paragraph 3, in case of any activity and changes that may occur in the landfill, the operator is obliged to immediately inform the competent authority.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Occupational health and safety measures</b></p> <p>The landfill operator is obliged to adhere to the Law on Safety and Health at Work.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Relocation of waste from landfills</b></p> <p>Relocation of waste from landfill can be done only if the wastes are delivered to the plant for use in burning of wastes for energy recovery or waste recycling plant.</p>	<p>operater je zaduzen da izvestava o stanju deponije svake godine, u toku pet (5) prvih godina, dok posle ovog perioda svake treće (3) godine.</p> <p>4.Sa izuzetkom iz stava 3, u slučajevima bilo koje delatnosti i promena koje mogu da se dese u deponiji, operater je obavezan da odmah informiše nadležni autoritet.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Bezbednost i zastita na poslu</b></p> <p>Operater deponije je obavezan da se pridrzava Zakon o bezbednosti i zdravlju na radu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Iznošenje otpada iz deponije</b></p> <p>Iznošenje otpada deponije, može se uraditi samo ako se otpad šalje na korišćenje u postrojenje za sagorevanje otpada radi dobijanja energije ili u postrojenje za reciklažu otpada .</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Njoftimi për mbylljen e deponisë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Notice of closure of the landfill</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Obaveštenje o zatvaranju deponije</b></p>
<p>1. Operatori i deponisë duhet të njoftoj Ministrinë se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbylljes së deponisë.</p> <p>2. Operatori i deponisë duhet të njoftoj operatorët për mbledhjen e mbeturinave dhe autoritetet kompetente se do ta ndërpresë pranimin e mbeturinave në deponi në afat prej një (1) viti, para ndërmarrjes së masave për mbyllje të saj.</p> <p>3. Operatori i deponisë, duhet të njoftoj Ministrin se ka zbatuar kushtet dhe kërkesat ligjore për mbylljen e deponisë dhe i ka përmbush obligimet sipas projektit si dhe ka ndërmarr masat për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis brenda afatit kohor të caktuar nga Inspektorati Mjedisor.</p> <p>4. Ministria, pas vlersimit të gjendjes në terren se janë plotësuar kushtet për mbyllje të deponisë dhe pranimin të raportit nga inspektorati mjedisor, lëshon vendimin me shkrim për mbylljen e deponisë.</p>	<p>1. Operator of landfill must announce the Ministry, that the closing conditions are fulfilled for starting the landfill closure;</p> <p>2. Operator of landfill shall announce the waste collection operators and competent authorities, that in period of 1 year, before taking action to shutdown the landfill;</p> <p>3. The operator of the landfill must notify the Minister that has implemented the terms and legal requirements of the Environmental Inspectorate for closure and it has fulfilled its obligations under the project and has taken measures to prevent negative impacts on the environment within the deadline set by the Environmental Inspectorate.</p> <p>4. The Ministry, after the assessment of the situation that the legal catch to close the landfill and the receipt of the report of the inspectorate environment, issue a written decision on the closure of the landfill.</p>	<p>1. Operater deponije treba da obaveštava Ministarstvo da su ispunjeni uslovi za početak zatvaranja deponije.</p> <p>2. Operater deponije mora da obavesti operatere za sakupljanje otpada i nadležni autoritet da će u roku od jedne (1) godine, prekinuti prihvatanje otpada u deponiji, pre preduzimanja mera za njeno zatvaranje.</p> <p>3. Operater deponije, mora da obavesti Ministarstvo da je primenio uslove, i zakonske zahteve i naredbe inspektorata sredine o zatvaranju deponije i da je ispunio obaveze u skladu sa projektom kao i da je preduzeo mere o spečavanju negativnih uticaja na sredinu u roku utvrđenom od inspektorata sredine.</p> <p>4. Ministarstvo, nakon procene stanja na terenu da su ispunjeni ulovi za zatvaranje deponije i prijema izveštaja od inspektorata sredine, izdaje pismeno rešenje o zatvaranju deponije.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Inicimi për mbylljen përfundimtare të deponisë</b></p> <p>1. Mbyllja e deponisë mund të iniciohet me kërkesën e arsyetuar, nga:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. inspektoriati mjedisor përgjegjës;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. komuna;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. operatori.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Initiation for landfill final closure</b></p> <p>1. Closing of the landfill could be initiated by reasonable requests from:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. responsible environmental inspectorate;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. municipality;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. operator.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Iniciranje konacnog zatvaranje deponije</b></p> <p>1. Zatvaranje deponije može da se započne opravdanim zahtevom, od:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. odgovorni Inspektorat za zivotnu sredinu;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. opštine;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.3. operatera.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Vendimi për mbylljen përfundimtare të deponisë</b></p> <p>1. Vendimi për mbylljen përfundimtare të deponisë përmbanë:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. përshkrimin e shkaqeve për mbylljen e deponisë;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. datën, kur deponia do ta ndërpresë pranimin e mbeturinave;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Decision of final closing the landfill</b></p> <p>1. Decision for landfill final closure content:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. description of causes for closing the landfill;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. date, when landfill will stop to accept wastes;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Rešenje o konačnom zatvaranju deponije</b></p> <p>1. Rešenje o konačnom zatvaranju deponije sadrži:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. opis uzroka zatvaranja deponije;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. datum, kada će deponija prekinuti odlaganje otpada;</p>

<p>1.3. urdhëresën për operatorin e deponisë për ndërprerjen e aktiviteteve operuese dhe varësisht prej gjendjes në teren ndërmarrjen e masave eventuale për të pasur sa më pak ndikime negative në mjedis, siç janë:</p> <p>1.3.1. largimin apo bartjen eventuale të mbeturinave në deponinë tjetër;</p> <p>1.3.2. mbulimin e mbeturinave me shtresa dheu;</p> <p>1.3.3. vendosjen e rrethojave;</p> <p>1.3.4. formësimin e sipërfaqes së deponisë dhe rregullimin e sajë me pjerrtësi të duhur;</p> <p>1.3.5. rregullimin dhe ndërtimin e kanaleve për kullimin e ujërave.</p> <p>2. Deponia konsiderohet e mbyllur nga operatori vetëm atëherë kur Ministria, konstaton se janë përmbushur të gjitha obligimet ligjore dhe lëshon vendimin me shkrim për mbylljen përfundimtare të deponisë.</p>	<p>1.3. ordinance for a landfill operator for termination of operating activities and depending on the situation on the field, for undertaking possible measures to have less negative impacts on the environment, such as:</p> <p>1.3.1. removing or eventual waste conveyance in other landfill;</p> <p>1.3.2. initial cover of the wastes;</p> <p>1.3.3. set up of hedges;</p> <p>1.3.4. forming of landfill surface and its regulation of adequate slope;</p> <p>1.3.5. regulation and construction of canals for water filtration.</p> <p>2. Landfill will be considered as closed, when the Ministry ascertains that are accomplished all legal obligations and issue the written decision of final closure of this landfill.</p>	<p>1.3. naredbu za operatera deponije o prekidu aktivnosti operatera i u zavisnosti od stanja na terenu preduzimanje mera da bi imali što manje negativnih uticaja na sredinu, kao što su:</p> <p>1.3.1. uklanjanje ili eventualno prenošenje otpada u drugu deponiju;</p> <p>1.3.2. pokrivanje otpada slojevima zemljišta;</p> <p>1.3.3. postavljanje ograde;</p> <p>1.3.4. oblikovanje površine deponije i njihovo regulisanje sa potrebnim nagibom;</p> <p>1.3.5. uređivanje i izgradnju kanala za odvod vode.</p> <p>2. Deponija se smatra zatvorenom od operatera samo onda kada Ministarstvo oceni da su ispunjene sve Zakonske obaveze i izdaje pismeno rešenje za zatvaranje deponije.</p>
---	---	--

<p>3. Operatori i deponisë edhe pas mbylljes përfundimtare mbetet përgjegjës për mirëmbajtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e saj sipas afatit të përcaktuar në nenin 27, të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Dyllosja-Mbulesa përfundimtare e deponisë</b></p> <p>1. Dyllosja - mbulesa përfundimtare në deponi, duhet:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. të ofrojë mbrojtje kundër depërtimit të ujit në mbeturina të deponisë;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. të ofrojë mbrojtje ndaj erozionit;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. të plotësoj kërkesat estetike ndaj hapësirës në dhe rreth deponisë;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. të mundësoj në kushte të caktuara përdorimin e hapësirës së rikultivuar të deponisë.</p> <p>2. Mbulesa përfundimtare e deponisë përbëhet nga këto shtresa:</p>	<p>3. The operator of the landfill and after final closure remains responsible for maintenance, supervision and control by its deadline determined in Article 27 of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Final covering of landfill</b></p> <p>1. Final covering on landfill should:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. offer protection against water infiltration on waste landfill;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. offer protection against erosion;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. fulfill esthetic requests on spatial and around the landfill;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. to enable, in certain conditions the use of re-cultivated space of landfill.</p> <p>2. Last cover of landfill involve the following levels:</p>	<p>3. Operater deponije i posle završnog zatvaranja ostaje odgovoran za održavanje, nadzor i njenu kontrolu prema roku odredjenom u članu 27, ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Voštenje-Završni pokrivač deponije</b></p> <p>1. Voštenje -Završni pokrivač deponije treba da:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. pruži zaštitu protiv deportovanja vode u otpad deponije;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. pruži zaštitu od erozije;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. da ispuni estetske zahteve okolnog zemljista deponije;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. da omogući u određenim uslovima korišćenje rekultivisane površine deponije;</p> <p>2. Završni pokrivač deponije sastavljena je od sledećih slojeva:</p>
---	---	---

<p>2.1. shtresa e parë, nënkuptohet shtresa e dheut të pa kategorizuar me trashësi më së paku 10 cm, e cila shërben për mbulimin, rrafshimin dhe formësimin e deponisë;</p> <p>2.2. shtresa e dytë përbëhet prej dy nënshtresave të argjilës të kompaktuara me trashësi më së paku prej 25 cm (të dy shtresat 50 cm);</p> <p>2.3. shtresa e tretë dhe përfundimtare përbëhet nga dheu i përshtatshëm (preferohet dheu humus) për rikultivim që duhet të ketë trashësi më së paku 40 cm.</p> <p>3. Operatori i deponisë, gjatë procesit të mbylljes së deponisë duhet të bëjë çmontimin e të gjitha pajisjeve dhe objekteve të cilat nuk do të jenë në funksion të mëtejme të deponisë.</p>	<p>2.1. first level, mean soil level with the width 10 cm, which is using for covering, flatting and landfill form;</p> <p>2.2. second level is content is content from two sub levels of compacted clay, width min from 25 cm (both levels 50 cm);</p> <p>2.3. third level and the last one content adequate soil (it is preferred humus soil) for re-cultivation which can have the width 40 cm.</p> <p>3. Landfill operator, during the closing process must demount all equipment and objects which will not be in function of landfill.</p>	<p>2.1. prvi sloj, podrazumeva sloj nekategorisanog zemljišta debljine najmanje 10 cm, koje se koristi za pokrivanje, izravnjavanje i oblikovanje deponije;</p> <p>2.2. drugi sloj sastoji se od dva glinena podsloja sabijena u debljini najmanje od 25 cm(oba sloja 50 cm);</p> <p>2.3. treći i završni sloj sastoji se od relevantnog zemljišta (poželno zemljište- humus) za rekultivisanje koje treba da je debljine najmanje od 40 cm.</p> <p>3. Operater deponije, u toku postupka zatvaranja deponije treba da demontira sva postrojenja i objekte koje neće biti daljnoj funkciji deponije.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Rikultivimi i deponisë</b></p> <p>1. Procesi i rikultivimit të deponisë fillon pas vendosjes së shtresës përfundimtare të dheut mbi mbeturina të deponisë.</p> <p>2. Rikultivimi duhet të bëhet në harmoni me peizazhin e hapësirës ku gjendet deponia dhe adaptimi i saj për qëllime të shfrytëzimit për rekreacion, pyllëzim apo bujqësi.</p> <p>3. Në deponitë e mbyllura nuk lejohet ndërtimi i objekteve për banim.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Landfill re-cultivation</b></p> <p>1. Re-cultivation process starts after the last soil level over the landfill wastes.</p> <p>2. Re-cultivation should be in harmonization with spatial landscape where is located the landfill, and its adaptation in order of using it for recreation, foresting and agriculture.</p> <p>3. On the closed landfill it's not allowed the constructions of the inhabitation objects.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Rekultivacija deponije</b></p> <p>1. Procesi rekultivacije deponije počinje posle stavljanja završnog sloja zemljišta na otpad deponije.</p> <p>2. Rekultivacija treba da bude u saglasnosti sa pejzažem površine gde se nalazi deponija i njenu adaptaciju u cilju korišćenja za rekreaciju, šumarstvo ili poljoprivredu.</p> <p>3. Na zatvorenim deponijama ne dozvoljava se izgradnja stambenih objekata.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Kontrolli dhe vetëmonitorimi</b></p> <p>1. Operatori, gjatë fazës operuese të një deponie, kryen procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit, sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Operatori informon Ministrin për çdo tejkallim të vlerave të paramentrave sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi administrativ.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Control and self-monitoring</b></p> <p>1. The operator, during operating a landfill, performs self-monitoring and controlling procedures, as specified in Annex 2 of this administrative instruction.</p> <p>2. The operator informs the Minister for any exceeded values of parameters as specified in Annex 2 of this administrative instruction.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Kontrola i samo praćenje</b></p> <p>1. Operater, u toku rada deponije, obavlja procedure kontrole i samo -praćenja, u skladu sa Dodatkom 2 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>2. Operater obaveštava Ministarstvo o svakom prekoračenju vrednosti parametara prema Dodatku 2 ovog Administrativnog uputstva.</p>



<p>3. Raportimi për të dhënat sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij udhëzimi administrativ bëhet në AMMK.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Monitorimi i deponisë</b></p> <p>1. Operatori i deponisë siguron monitorimin sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi administrative duke bërë:</p> <p>1.1. matjet e parametrave meteorologjik;</p> <p>1.2. matjet e emetimeve të gazrave të deponisë;</p> <p>1.3. matjet e emisioneve në shkarkimin e kullimit dhe ujërave të ndotura nga deponia;</p> <p>1.4. matjet e ujërave nëntokësore në zonën afër deponisë.</p> <p>2. Monitorimi operativ nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhet sipas Shtojcës 2 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>3. Reporting to the KEPA on the data provided for in paragraph 1 and 2 of this administrative instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Implementation of landfill monitoring</b></p> <p>1. Landfill operator must ensure the monitoring according to the Annex 2 of this administrative Instruction:</p> <p>1.1. measurements of meteorological parameters;</p> <p>1.2. measurements of landfill gas emissions;</p> <p>1.3. measurements of emissions and the discharge of wastewater drainage from the landfill;</p> <p>1.4. measurements of groundwater in the landfill.</p> <p>2. Operational Monitoring under paragraph 1 of this Article shall be in accordance with Annex 2 of this Administrative Instruction.</p>	<p>3. Izvješćavanje o podacima iz stava 1. i 2. ovog Administrativnog uputstva vrši se u KAZŽS.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Monitoring deponije</b></p> <p>1. Operater deponije obezbeđuje monitoring u skladu sa Dodatkom 2 ovog Administrativnog uputstva vršeći:</p> <p>1.1. merenja meteoroloških parametara;</p> <p>1.2. merenja emisije deponijskog gasa;</p> <p>1.3. merenja emisija ispuštanja iscedjevina i zagađenih voda iz deponije;</p> <p>1.4. merenja podzemnih voda u oblasti blizu deponije.</p> <p>2. Operativni monitoring iz stava 1 ovog člana, vrši se prema Dodatku 2, ovog Administrativnog uputstva.</p>
---	--	--

<p>3. Monitorimi sipas paragrafit 1 të këtij neni, behet nga labororet e akredituar.</p> <p>4. Të dhënat sipas nënparagrafit 1.1. të paragrafit 1, të këtij neni mbi matjen e parametrave meteorologjik të bëra nga Instituti Meteorologjik i Kosovës, i siguron operatori i deponisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Monitorimi i deponisë pas mbylljes përfundimtare</b></p> <p>1. Monitorimi dhe përkujdesja e deponisë pas mbylljes përfundimtare do të bëhet apo zgjatë për aq kohë deri sa ndikimi negativ në mjedis dhe në shëndetin e njeriut të konsiderohet minimal apo i pa rrezikshëm dhe që emisionet nuk tejkalojnë vlerat kufitare.</p> <p>2. Operatori i deponisë edhe pas mbylljes përfundimtare të deponisë apo të zonave të saj ka përgjegjësi për përkujdesjen si më poshtë:</p>	<p>3. Monitoring according to paragraph 1 of this Article, is done by accredited laboratories.</p> <p>4. Information under subparagraph 1.1. paragraph 1 of this article on the measurement of meteorological parameters made by the Meteorological Institute of Kosovo, shall provided by the landfill operator.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Monitoring landfill after the closing process</b></p> <p>1. Monitoring and after-care of the landfill after the closing will take place or last for so long until a negative impact on the environment and human health is considered minimal or no risk and that emissions do not exceed the limit values.</p> <p>2. The landfill operator after the final closure of the landfill or its areas responsible for after care as follows:</p>	<p>3. Praćenje prema stavu 1 ovog člana, vrši se od strane akreditiranih laboratorija.</p> <p>4. Podaci prema podstavu 1.1. stav 1, ovog člana o merenju meteoroloških parametara urađenih od strane Meteorološkog instituta Kosova, obezbeđuje operater deponije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Monitoring deponije nakon završnog zatvaranja</b></p> <p>1. Praćenje i posle-brigu deponije nakon zatvaranja će se održati ili traje toliko dugo dok se ne smatra negativan uticaj na životnu sredinu i zdravlje ljudi minimalan ili nikakav rizik i da ne emisije ne prelaze granične vrednosti.</p> <p>2. Deponija operater nakon konačnog zatvaranja deponije ili njenih oblasti koja je odgovorna za posle nege na sledeći način:</p>
--	---	---

<p>2.1. Për mirëmbajtjen, monitorimin dhe kontrollin e gazit dhe kullimit të deponisë si dhe regjimin e ujërave nëntokësore të/afër deponisë në përputhje me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ deri sa Inspektorati mjedisor i Ministrisë të vlerëson apo konsideron se deponia nuk paraqet rrezik për mjedisin.</p> <p>2.2. Nëse gjatë kontrollit të deponisë, zbulon apo identifikon ndikimet negative në mjedis duhet të njoftojë Inspektoratin mjedisor të Ministrisë dhe të zbatoj vendimin e Inspektoratit për masat korrigjuese që duhet të ndërmerret.</p> <p>2.3. Të monitorojë stabilitetin e deponisë dhe të marr masat e duhura për të siguruar stabilitetin e saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Tarifa për deponim të mbeturinave</b></p> <p>1. Përcaktimi i tarifës për deponimin e mbeturinave duhet të marr për bazë aspektin social, ekonomik dhe mjedisor në mënyrë që</p>	<p>2.1. Maintenance, monitoring and control of gas and leachate of landfill and regime groundwater near the landfill in accordance with the provisions of this Administrative Instruction until the Environmental Inspectorate of the Ministry appreciates considers that the landfill does not pose a risk to the environment.</p> <p>2.2. If control over the landfill, detects or identifies negative impacts on the environment must notify the Environmental Inspectorate of the Ministry and the Inspectorate's decision to implement corrective measures to be taken.</p> <p>2.3. The monitoring stability of the landfill and take the appropriate measures to ensure its stability.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>The fee for waste disposal</b></p> <p>1. Determination of fee for waste disposal must take into account social aspects, economic and environmental development</p>	<p>2.1. Održavanje, praćenje i kontrola gasa i deponije odvodnjavanje i režima / podzemnih voda u blizini deponije u skladu sa odredbama ovog Administrativnog uputstva do Inspekcija za životnu sredinu Ministarstva ceni smatra da deponija ne predstavlja opasnost za okolinu;</p> <p>2.2. Ako kontrola deponije, detektuje ili identifikuje negativne uticaje na životnu sredinu mora da obavesti inspekciju Ministarstva životne sredine i odluku Inspektorata da sprovede korektivne mere koje treba preduzeti.</p> <p>2.3. Prati stabilnost deponije i preduzeti odgovarajuće mere za njegovu stabilnost.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Tarifa za skladištenje otpada</b></p> <p>1. Odredjivanje tarife za skladištenje otpada za osnovu se treba uzeti socijalni, ekonomski aspekt tako da tarifa za</p>
--	---	---

<p>tarifa për deponim të mbeturinave të jetë sa ma reale për gjeneruesin e mbeturinës dhe operatorin e deponisë.</p>	<p>in order that the fee for disposal of waste to be real for generators of waste and landfill operator.</p>	<p>skladištenje otpada bude što realnija za generatora otpada i operatera deponije;</p>
